



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS · REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Prilijeno Më/Dana 29-03-2024 v.lgod			
Nr. i organit Org. broj	Numri/Broj	Shtetë Prillog	Vlera Vleratort
02-	035	02-	302



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr 03/L-040 (Gazeta zyrtare nr 28/2008), Ligjit mbi shpronësimin e pronës së Paluajtshme nr. Nr. 03/ L-139, neni 3 pika 2, neni 4 pika 3, neni 7 pika 2, neni 8 pika 5 të dispozitave të ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me nr.03/L-205 dhe sipas kërkeses me numër 07-070/01-218 e datës 14.03.2024 nga Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodozi dhe neni 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës së Vitisë, me datë 29.03.2024 merr këtë:

## V E N D I M

- I. **Miratohet** -Kërkesa për fillimin e procedurës për shpronësimin e pronës së paluajtshme nga Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodozi dhe vetë iniciimi nga Kryetari i Komunës z.Sokol Haliti dhe procedohet për shqyrtim të mëtejme

## A r s y e t i m

Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodozi ka paraqitur kërkesë me nr te protokollit me numër 07-070/01-218 e datës 14.03.2024, dhe me vetë iniciativë të kryetarit të Komunës, përmes sektorit të shpronësimit për ngastren kadastrale P-70101027-00002-3 me sipërfaqe 4138m<sup>2</sup>, zonen kadastrale Letnicë në emër të pronarit Jakov Matiq (Tadeja) nga fsh. Letnicë, me qëllim që të bëhet zgjerimi i ndertimit te rezervave te Fabrikes së Ujit në fshatin Letnicë, Komuna e Vitisë.

Andaj edhe Kërkesa është bazuar në ligjin për Shpronësim e pronës së paluajtshme nr.03/L-139 dhe dispozitave të ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me nr.03/L-205, dhe u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këtij vendimi ja bashkëngjisim edhe kërkesën nga Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me nr të protokollit me numër 07-070/01-218 e datës 14.03.2024

Vendimi u dorëzohet:

1. Drejtorisë për Kadaster, Pronë dhe Gjeodozi
2. Zyrës së Kryetarit
3. Arkivit

KRYETARI KOMUNËS  
Sokol Haliti

